

# **AKTI I THEMELIMIT**

**DHE**

**STATUTI**

**I**

**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**“ALB MUFERAS- EXPORT IMPORT INDUSTRY”**

## **KREU I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia.**

## **Neni 1**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit.**

Sot më daten 15.08.2018, ne themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar me emrin **“ALB MUFERAS-EXPORT IMPORT INDUSTRY”**

1) Themeluesit e shoqërisë janë:

- 1- Z. NIKOLLE NDOCI**, lindur me 01.08.1967, ne Gjader, Lezhe, shtetas Shqiptar, i identifikuar me ane te leternjoftimit elektronik me nr. 024432853 dhe nr personal G70801069S, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar,
- 2. Z. MUWAFAQ AL HUSSEIN**, lindur më 15.02.1969, në Damask, Siri shtetas Sirian, mbajtëse i pasaportes me nr. N011635343, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- 3. Znj. RAWA HALABI**, lindur më 13.03.1964, në Damask, Siri shtetase Siriane, mbajtëse e pasaportes me nr. N011347776, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- 4. Z. MHD FERAS ALAZZAM**, lindur më 08.01.1976, në Damask, Siri shtetas Sirian, mbajtës i pasaportes me nr. N012100087, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

## **Neni 2**

**Objekti**

2.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Grumbullim, perpunim dhe eksport te produkteve industriale dhe tekstile.
- Import te lendeve te para per prodhimin e produkteve industriale dhe tekstile.
- Kryerjen e cdo lloj aktiviteti te lejuar nga legjislacioni shqiptar.

2.2 Shoqëria do të kryejë cdo lloje veprimtarie të dobishme për arritjen e objektivave të saj, duke përfshirë edhe veprimtari për shit-blerje sendesh të luajtshme dhe të paluajtshme, pjesmarrje në kuota dhe aksione në shoqëri dhe ndërrmarje të tjera.

**Neni 3**  
**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë **pa afat**.

**Neni 4**  
**Selia**

4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën : *Njesia Bashkiake nr.2, Rruga "Pjetër Budi", ndertesa nr.3/350, Hyrja 1, Kati 1, Ap 3, Tirane.*

4.2 Shoqëria mund të krijojë qëndra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi si dhe agjensi në adresatë tjera në territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj.

**KREU II**  
**Kapitali**

**Neni 5**  
**Kapitali Themeltar**


Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë eshte 100 000 Lek (Njeqind mijë).

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- 1- Z. NIKOLLE NDOCI - zoterues i 1 (nje) kuote me vlore te pergjithshme prej 25 000 (njezete e pese mijë) leke te reja qe perben 25% te kapitalit themeltare te shoqerise.**
- 2- Z. MUWAFAQ AL HUSSEIN – zoterues i 1 (nje) kuote me vlore te pergjithshme prej 25 000 (njezete e pese mijë) leke te reja qe perben 25% te kapitalit themeltare te shoqerise.**
- 3- Znj. RAWA HALABI - zoterues i 1 (nje) kuote me vlore te pergjithshme prej 25 000 (njezete e pese mijë) leke te reja qe perben 25% te kapitalit themeltare te shoqerise.**
- 4- Z. MHD FERAS ALAZZAM - zoterues i 1 (nje) kuote me vlore te pergjithshme prej 25 000 (njezete e pese mijë) leke te reja qe perben 25% te kapitalit themeltare te shoqerise.**

**Neni 6**  
**Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit.**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve te kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto contribute sipas kërkesës së administratorit.



Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë ortakun për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit bëhet me vendim të asamblesë së ortakëve, i cili meret në të njejtat kushte si për ndryshimin e statutit.

Në cdo rast zvogëlimi i prek ortakët në të njejtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### **Neni 7**

#### **Transferimi i Kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund

të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ne statut kushtëzohen kalimi i kuotave te treteve jashte shoqerise, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modalitetave dhe shumices se cilesuar qe kerkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombëtare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr.

9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

#### **KREU III**

#### **Organet Vendimmarrëse dhe Drejtuese**

#### **Neni 8**

#### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modalitetave te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

#### Neni 9

#### Mënyra e Thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme e ortakëve thirret nëpërmjet një njoftimi me shkres ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi duhet të përbaje vëndin, datën, orën e mbledhjes, si dhe rendin e ditës si dhe t'u dërgohet ortakeve jo më vonë se 7 para ditës së mbledhjes.

Kur asambleja është mbledhur jo sipas pikës 1 te këtij neni, ajo mund të marë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort për marrjen e vendimeve, pavarsisht parregullsisë.

#### Neni 10

#### Kourumi

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, miratimin e bilancit, kontrollin e llogarive, miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë, riorganizimin, bashkimin ose ndarjen e shoqerise, shnderimin ne një forme tjeter, transferimin e kuotave, emerimin e eksperteve dhe likuidatoreve dhe prishjen e shoqërisë, zhvillon mbledhje te jashtezakonshme, te cilat janë te vlefshme, kur ne te janë te pranishem ortakët me te drejte vote qe zoterojne me shume se

gjysmen e numrit total te kuotave te kapitalit te shoqerise te cilet votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligjit 9901 date 14.04.2008 dhe merren vendime te vlefshme me votimin pro te  $\frac{3}{4}$  te ortakeve pjesemarres.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, kur ne te marrin pjesë ortakët me të drejtë vote te cilet zoterojnë më shumë se 40 për qind të kuotave për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.

#### Neni 11

#### Perjashtimi i Ortakut.

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.


#### Neni 12

#### Administrimi

Shoqeria do të administrohet nga 4 ( kater) administrator. Administrator te shoqërisë jane:

##### 1. Z. NIKOLLE NDOCI

- Speciment i nënshkrimit:




##### 2. Z. MUWAFAQ AL HUSSEIN

- Speciment i nënshkrimit:




##### 3. Znj. RAWA HALABI

- Speciment i nënshkrimit:



##### 4. Z. MHD FERAS ALAZZAM

- Speciment i nënshkrimit:



Administratorret do të ushtrojë detyrën e tyre sipas statutit dhe ligjit për një periudhe 5 vjecare me të drejtë ripërtëritje.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Administrator i shoqerise mund të emerohet edhe një person jashtë ortakërisë.

### Neni 13

#### Kompetencat e Administratorit

Administratori, zoti Nikolle Ndoci, do te kryeje proceduren e regjistrimit te Shoqerise ne QKB Administratori/et kane të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejn të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) Përfaqësojnë shoqërinë tregtare pas regjistrimit ne QKB;
- c) Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) pëргatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Se paku, njeri nga Administratorret eshte i detyruar të thërrasë mbledhjen e ortakeve vetem edhe ne rastet kur :

- 1- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- 2- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratoret kane të drejtë të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm. Administratoret përfaqësojnë Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratoret kane të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rr Ethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratoret angazhojne shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratoreve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rr Ethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

#### Neni 14

#### Përgjegjësite e Administratorit/ve

Administratori/et eshte/jane përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori/et detyrohet/en:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarës së shoqërisë në mjes;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

c) të parandalojë dhe mënjanjoë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratoriet, gjatë kryerjes së detyrave të tij/tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori/et vepron/jne në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori/et ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori/et eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit/eve, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit/eve Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit/ve për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **KREU IV** **Viti finanziar-ekspertet**

##### **Neni 15** **Viti Financiar**

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

##### **Neni 16** **Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithheyjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të

ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

## **KREU V**

### **Prishja –riorganizimi i shoqërisë**

#### **Neni 17**

##### **Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer vepramtari tregtare pér dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Pér Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqli ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërite tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim pér emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, pér të caktuar një likuidues.

#### **Neni 18**

##### **Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Pér tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

#### **Neni 19**

##### **Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe qfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 20**

**Mosmarrëveshjet**


Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**ORTAKET  
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“ALB MUFERAS- EXPORT IMPORT INDUSTRY”**

Z. NIKOLLE NDOCI

*Nikolle Ndoçi*



Z. MUWAFAQ AL HUSSEIN

*MUWAFAQ AL HUSSEIN*



Znj. RAWA HALABI

*RAWA HALABI*



Z. MHD FERAS ALAZZAM

*MHD. FERAS ALAZZAM*

